



KUVENDI I KOMUNËS KOMITETI PËR POLITIKË DHE FINANCA

Procesverbal i mbajtur më 25 qershor 2021, në mbledhjen e XXXVIII-të (tridhjetë e tetë) mandati VI, të Komitetit për Politikë dhe Financa.

Mbledhja u mbajt në sallën e mbledhjeve të Kuvendit, ndërtesa e re e Komunës, kati përdhës, dhe filloi në orën 10;10

Mbledhjen e hapi dhe kryesoi z.Fatmir Gashi, Kryesues i Kuvendit, përkatësisht kryesues i këtij Komiteti.

Fillimisht u konstatua se në mbledhje ishin të pranishëm të gjithë anëtarët e këtij Komiteti: Mehmet Gashi, Arlinda Kadriu, Fatlume Jaha, Adelinë Stublla, Florent Hasani, Rafet Llapashtica, Endritë Murati, Patriot Rudari.

Me këtë u konstatua se ekziston kuorumi për punë.

Në mbledhje të pranishëm ishin; Bahri Selimi, drejtor i Drejtorisë së Administratës-DA, Elhame Kutllovci, drejtoreshë e Drejtorisë së Kulturës Rinisë dhe Sportit – DKRS, Fatlum Osmani, drejtor i Drejtorisë së Buxhetit dhe Financave, Avni Fetahu, drejtor i Drejtorisë së Arsimit-DKA, Bujar Hasani, drejtor i Drejtorisë së Planifikimit Urban dhe Mbrojtjes së Mjedisit-DPUMM.

Rendi i ditës

z.Fatmir Gashi, Kryesues i Komitetit, e hapi mbledhjen duke i falënderuar dhe përshëndetur të pranishmit, theksoi, nëse ka dikush diçka për të shtuar urdhëroni, nëse nuk ka diçka për të shtuar e vë në votim rendin e ditës.

Njëzëri miratohet rendi i ditës sipas thirrjes dh materialit përkatës.

1. Procesverbali nga mbledhja e Komitetit për Politikë dhe Financa e mbajtur më 02 qershor 2021

z.Fatmir Gashi, Kryesues i Komitetit, theksoi, nëse nuk ka dikush çfarë të shtojë lidhur me këtë pikë dhe gjithçka është në rregull unë e hedh në votim.

Njëzëri, pa vërejtje apo plotësim ndryshime, miratohet procesverbali i mbledhjes së KPF-së së mbajtur më 02 qershor 2021.

2. Korniza Afatmesme Buxhetore 2022/2024 e Komunës së Podujevës

z.Fatlum Osmani, drejtor i Drejtorisë për Buxhet dhe Financa-DBF, e paraqiti fjalën hyrëse rreth këtij dokumenti, ndër të tjera theksoi, Korniza Afatmesme Buxhetore është një dokument shumë i rëndësishëm që për nga aspekti kohor duhet të miratohet gjatë muajit qershor dhe deri në fund të qershorit kjo KAB 2022/2024 duhet të procedohet në Kuvend për miratim, dokument në të cilin janë projektionet buxhetore dhe projektionet për investimet çoftë kapitale, çoftë mallra dhe shërbime, çoftë subvencione, çoftë në kategorinë e pagave për periudhën e ardhshme 3 vjeçare.

Në bazë të Qarkores buxhetore e cila është sjellë nga Ministria e Financave, buxheti i Komunës së Podujevës për vitin 2022 është 23,549,520.00€, për 2023 është 24,658,512.00€, ndërsa për vitin 2024 është 25,859,552.00€, do të thotë për çdo vit ka një ngritje buxhetore të lehtë. Kornizën Afatmesme Buxhetore 2022/2024 të Komunës së Podujevës po besoj që të gjithë e keni dhe keni pas mundësi ta lexoni, shqyrtoni dhe analizoni me kohë sepse edhe materiali ju është dërguar me kohë 7-8 ditë pune para kësaj mbledhje. Për këtë dokument i kemi mbajtur edhe dëgjimet publike dhe në bashkëbisedim me qytetarët dhe në bazë të kërkesave dhe nevojave të tyre kemi bërë përpjekje maksimale që kjo Kornizë t'ju përgjigjet nevojave në tërë qytetin dhe qytetarët e saj. Vlen të ceket dhe diskutohet në mbledhjen e Kuvendit të Komunës që kjo KAB i portretizon investimet në arsim, shëndetësi, në ekonomi, në kulturë, ndoshta vlen të ceket që në këtë kategori për çështjen e arsimit vetëm për çështjen e rialokimit në shkolla ka 6.5 herë rritje të buxhetit. Gjithashtu ka rritje të buxhetit për 21% edhe në kategorinë e pagave dhe shërbimeve në arsim, pastaj edhe për subvencione të bursave për student ka një rritje prej 20%.

Në çështjet e ekonomisë kemi një rritje prej 8.2 herë më shumë, ku parashihet investime në zonën ekonomike, po ashtu subvencionet për bizneset, subvencionet për zonat e interesit për bizneset prodhuese dhe subvencionet për bashkëpunim me donatorët e ndryshëm. Tek kultura gjithashtu kemi një rritje për 36% ku parashihet fillimi investimeve për ndërtimin e shtëpisë së kulturës që është më e rëndësishme. Tek çështjet tjera të urbanizmit janë planifikuar projekte që sigurisht janë më shumë të rritjes së projekteve zhvillimore në infrastrukturë siç janë rruga “Skënderbeu” dhe rruga “Xhemajl Mustafa” në vlerë prej 1,193,000.00€, mandej vazhdimi i ndërtimit të rrugës “Vëllezërit Frashëri” që është te Xhamia e qytetit, si dhe projekte të tjera, unë ju propozoj që të rekomandoni këtë pikë të rendit të ditës për shqyrtim në mbledhjen e Kuvendit dhe sigurisht gjatë asaj mbledhje do të diskutohen më hollësisht këto projekte.

z.Mehmet Gashi, theksoi, kërkoja fjalën meqenëse kam një provojë për një kohë të gjatë rreth propozim Kornizës Afatmesme Buxhetore dhe dëshiroj të jap disa sugjerime fillimisht, këtu në material e kemi Korniza Afatmesme Buxhetore 2022/2024, por duhet ta dimë që çdo dokument që del për shqyrtim derisa të miratohet është propozim dhe është mirë edhe këtu në material të jetë propozim Korniza Afatmesme Buxhetore, madje është mirë që të cekem edhe afatet dhe muajt kur është përgatitur për hir të korrektësisë dhe transparencës.

Pastaj kam edhe disa vërejtje teknike por nuk po dëshiroj të lëshohem më tepër në atë, mirëpo dëshiroj të ndalem te planifikimet për investime kapitale sepse kategoritë tjera po thuajse janë të përcaktuara në bazë të instruksioneve financiare që vijnë nga Ministria e Financave, pra pagat dhe mëditje dihet sepse janë llogaritur në shërbyes civil, sektor të arsimit dhe në atë të Shëndetësisë ku në bazë të koeficienteve është lehtë të dihet buxheti, gjithashtu edhe te kategoria mallra dhe shërbime edhe pse është mirë çdo vit të zvogëlohet buxhet për këtë kategori sepse ka disa furnizime që bëhen 1 vit ndoshta në 4 vite nuk bëhen më, ashtu siç është edhe për komunal. Si Kuvend më shumë kemi të bëjmë me kategorinë e investimeve kapitale se ku po i orientojmë mjetet sipas KAB, e veçmas për vitin e ardhshëm e që duhet të miratohet në muajin shtator të këtij viti, pra KAB është bazë për miratimin e buxhetit të Komunës për

vitin 2022 e që duhet të miratohen deri më 30 shtator që është afati i fundit për miratim, kurse për vitet tjera 2023-2024 më tepër janë vetëm parashikime dhe ato mund edhe të ndryshohen mirëpo si dokument është mirë që ato me qenë sa më preciz për të qenë të qëndrueshme.

Diçka që kam vërejtur tek investimet kapitale është se ne shpesh herë kemi pasur vërejtje sidomos nga LVV-ja se projektet meqenëse tani e dimë që të gjitha rrugët në territorin e Komunës së Podujevës e që janë rreth 1400-1500 rrugë të emërtuara dhe të cilat figurojnë me gjatësi, gjerësi dhe gjitha çështjet tjera, por sërish e kemi vetëm një përgjigje apo emërtim të projektit ku thuhet asfaltimi i rrugëve në qytet, asfaltim i rrugëve në fshatra e kështu me radhë e që kjo ka qenë kritikë dhe vërejtje e vazhdueshme edhe e LVV-së, andaj është dashtë të specifikohen ashtu siç ka kërkuar edhe vetë LVV në të kaluarën që të precizohen, numrin apo kodi e rrugës, emrin e rrugës dhe të dimë se cilat rrugë do të asfaltohen, dhe po ashtu e njëjta vlen edhe për projektet e ndërtimit të kanalizimeve sepse i kemi shumë të përgjysmuara.

Unë nuk po mund ta di se për cilat rrugë të qytetit bëhet fjalë sepse kjo vazhdimisht përsëritet, ndërsa pyes drejtorin e DBF a i dini të paktën 2-3 rrugë të qytetit që janë të emërtuara e që nuk janë asfaltuara, kështu që më tepër tani të orientohemi tek rrugët e familjeve/lagjeve, shembull ndokush e kërkon edhe ne oborr të shtrohen asfalt apo kubza, mirëpo është mirë t'i precizojmë. Për disa projekte siç është rruga "Skënderbeu" dhe "Xhemajl Mustafa" është e qëlluar planifikimi dhe ato dy rrugë janë planifikuar edhe në vitin e kaluar dhe ka nevojë që të asfaltohen mirëpo rruga e cila lidhet me magjistralen Prishtinë – Podujevë deri tek "Vëllezërit Frashëri" ne po ashtu në 3 vitet fundit kemi investime rreth 1 milion euro, prandaj është mirë nëse i dimë përafërsisht para-masat dhe para-llogarinë, apo kemi projekt zbatues, të paktën ta dimë çmimin sipas para-llogarive dhe madje ta kemi projekt 1 vjeçar apo më së shumti 2 vjeçar jo më shumë..

Për disa rrugë e di se ka kërkesa të mëhershme sidomos në këto viset kodrinor-malore, shembull i kemi viset ku kanë filluar zhvillimi i bizneseve të ndryshme sidomos bletaria pastaj blegtoria, është mirë të përfundohen edhe për hir të zonave kufitare që janë zbrazur dhe të krijohen mundësitë dhe të stimulohen bujqit, bie fjala për rrugën Murgull-Marincë e cila afërsisht i ka 3.5 kilometër gjatësi dhe në të cilën ka një qarkullim i madh por që pothuajse është e pa kalueshme andaj është mirë të paktën këtë vit me rregullu me zhavorr për shkak se është shumë e pa kalueshme por që në atë pjesë kanë filluar edhe biznese të ndryshme. Pastaj edhe fshati Tërnavicë janë disa familje që kanë filluar të kthehen dhe kanë disa biznese por është mirë edhe ato rrugë të planifikohen për investime, kështu që ju bëjë lutje edhe drejtorëve që nëse disa rrugë nuk janë mirë por që nuk ka mjete të planifikuara për ato rrugë, ta bëjnë rialokimin e buxhetit dhe të ndajnë mjete për rregullimin e tyre sepse ka shumë nevojë.

Unë nuk po e zgjati më shumë sepse e kemi edhe mbledhjen e Kuvendit që do të mbahet ku me siguri se do të ketë edhe kërkesa tjera në Kuvend, mirëpo është mirë që çdoherë pozita me opozitë të harmonizohen në mënyrë që me qenë unanim edhe në votimin e buxhetit, prandaj nëse nuk merren për bazë edhe kërkesat e opozitës natyrisht pastaj edhe tek votimi mund të ketë probleme, andaj ka mundësi të plotësohet ky dokument dhe të korrigjohen gabimet teknike që nuk janë ndoshta me rëndësi aq të përmenden këtu, por meqë janë të korrigjohen.

z.Florent Hasani, theksoi, Grupi i LVV-së vazhdon të mbajë qëndrimin që termat (disa rrugë) të bëhet evidentimi i tyre dhe të përmirësohet kjo pjesë, pra të evidentohen rrugët, përndryshe këtë pikë të rendit të ditës e rekomandojmë për shqyrtim në Kuvend.

z.Rafet Llapashtica, theksoi, edhe ne Grupi i këshilltarëve të PDK-së i rekomandojmë Kuvendit si pikë të rendit të ditës, pastaj në mbledhjen e Kuvendit e diskutojmë më gjerësisht.

z.Fatlum Osmani, drejtor i DBF-së, theksoi, faleminderit për vërejtjet dhe sugjerimet e bëra, ne edhe gjatë fazës së përpilimit kemi qenë shumë të hapur dhe jemi të hapur ende për bashkëpunim rreth miratimit të kësaj Kornize Afatmesme Buxhetor, dokument për të cilin jemi në dijeni se përveç që është e nevojshme miratimi i saj është dokument pararendës i miratimit të buxhetit të Komunës, pra ky dokument

sërish do të kthehet domosdoshmërisht në projekte si një detyrim ligjor që sigurisht i paraprinë miratimit të buxhetit dhe projektet që janë në Kornizën Afatmesme Buxhetore sigurisht që e kemi kohën edhe t'i inkuadrojmë në planifikimin për buxhetin që është miratuar në vitin 2021.

Çështjet që i diskutova nuk po dëshiroj të kthehem sërish prapa por sinqerisht edhe në bashkëpunim me qytetarët por edhe faktikisht përgjithësisht është krijuar një opinion publik që është dhënë në Podujevë e që po besoj se është me të drejtë që arsimit dhe infrastruktura arsimore është jashtëzakonisht keq, përveç këtij vit që janë duke bërë investime për renovim dhe kemi paraparë që të jetë 6.5 herë më shumë buxhet në infrastrukturën arsimore, ne dimë që niveli qendror e ka një grand specifik për arsim dhe po ashtu edhe për shëndetësi, e që ta zëmë normalisht nuk kemi të drejtë të merremi me grand, por kemi të drejtë t'i shtojmë / të rrisim buxhetin qoftë nga të hyrat vetanake qoftë nga grandit i përgjithshëm, e që një gjë të tillë e kemi bërë sepse tek çështjet e arsimit ka një rritje nga grandit i përgjithshëm, përkatësisht nga të hyrat vetanake. Gjithashtu janë planifikuar investime të rëndësishme në fushën e kulturës dhe sportit, pastaj në fushën e ekonomisë ku ka projekt konkret dhe siç i cekta edhe më herët ka më shumë rritje buxhetore, mandej edhe shëndetësia e që të jemi realistë për situatën në shëndetësi janë grande të mjaftueshme për investime, mirëpo diçka që është problematike është tek çështja e subvencioneve ku po jemi të kufizuar me Qarkoren Buxhetore sa i përket planifikimeve buxhetore, shembull ka nevojë për rritje të subvencioneve në shëndetësi, ka nevojë për rritje të subvencioneve në ekonomi, ka nevojë për rritje të subvencioneve në shëndetësi në të gjitha përkrahjet ka nevojë për më shumë buxhet, mirëpo këto po i kufizon Qarkorja Buxhetore që rrjedhimisht nuk mund të dalësh përtej saj.

Si do që të jetë ne jemi të hapur edhe gjatë miratimit të Kornizës Afatmesme Buxhetore, por edhe pas miratimit të saj, sigurisht nëse ja vlen që me miratimin e buxhetit, të gjitha vërejtjet dhe propozimet e juaja si Kuvend mund t'i inkuadrojmë në buxhetin e vitit 2022.

z.Fatmir Gashi, Kryesues i Komitetit, theksoi, nëse nuk ka ndokush çfarë të shtoj unë e hedh në votim.

Njëzëri i rekomandohet Kuvendit për shqyrtim

3. Propozim Rregullorja e punës së Këshillit Drejtues të Teatrit të Qytetit të Podujevës “Avdush Hasani”

- Raporti nga diskutimi / debati publik

znj.Elhame Kutllovci, drejtoreshë e Drejtorisë së Kulturës Rinisë dhe Sportit-DKRS, e paraqiti raportin, përkatësisht Propozim Rregulloren në fjalë, ndër të tjera theksoi, siç jeni në dijeni DKRS para disa muajve ka sjellë në Kuvend Propozim Rregulloren në fjalë së bashku me propozimin për diskutim dhe debat publik ku edhe ka marrë miratimin që drafti i Rregullores së punës së Këshillit Drejtues të Teatrit “Avdush Hasani” të nënshtrohet diskutimit publik për 1 muaj.

Debati publik është organizuar më 10 mars 2021 ku gjatë diskutimit të pranishëm kanë qenë 13 artistë ku janë bërë diskutime të ndryshe rreth kësaj fushe mirëpo nuk ka pasur propozime konkrete nga ana e tyre.

Po ashtu ne si DKRS-së e kemi parë të nevojshëm plotësim-ndryshimin e nenit të 7 të kësaj propozim rregulloreje, siç e dini neni 7 i kësaj rregulloreje thotë “*kompensimi për anëtarët e këshillit për pjesëmarrje në takime bëhet në shumën ekuivalente të anëtarëve të KPF-së*”, ndërsa propozimi për plotësim ndryshimin e nenit 7 është “*Kompensimi për anëtarët e këshillit bëhet me shumën ekuivalente me atë të anëtarëve të KPF-së, dhe atë jo më shumë se një mbledhje në muaj gjatë vitit fiskal*”. Plotësim ndryshimin të cilin e kemi parë të nevojshëm për shkak se duhet të përcaktohet edhe numri i mbledhjeve për gjithë vitin e që në kuadër të mbledhjeve të mbajtura duhet të parashihet edhe kompensimi për punën e

anëtarëve të Këshillit, andaj unë e propozoj që t'i rekomandohet Kuvendit kjo pikë të rendit të ditës si dhe e njëjta të miratohet dhe pas procedurave tjera të përcaktimit ligjor të hyjë në funksion.

znj.Fatlume Jaha, theksoi, atëherë ne Grupi i këshilltarëve të LDK-së, e rekomandojmë për Kuvend këtë pikë të rendit të ditës, përkatësisht për seancën e ardhshme por vetëm kisha një pyetje për drejtoreshën e DKRS-së, këtu tek neni 2 pika 2 e propozim Rregullores thotë se njëri prej 5 anëtarëve të Këshillit duhet të jetë përfaqësues i Komunës së Podujevës, a është i specifikuar qartë se a duhet të jetë zyrtar i DKRS-së apo nga Ekzekutivi, ndoshta do të ishte më mirë ta specifikojmë për shkak që në të ardhmen mos të ketë paqartësi në lidhje me të.

Përveç kësaj për nenin që u cek se e keni parë të arsyeshme ta ndryshoni, unë pajtohem plotësisht që është mirë të qartësohet në mënyrë që në të ardhmen të mos ketë paqartësi në lidhje me kompensimin që iu bëhet anëtarëve të Këshillit, por më duket se e kam parë diku në dokumentet e Komunës tonë apo diku tjetër që zakonisht kur ka të bëjë kompensimi në shumën e caktuar, thuhet që kompensimi të jetë ekuivalent me shumën e komiteteve të përhershme të Komunës, sepse dihet për çfarë shume bëhet fjalë por më duket se e kam hasur në termin që është ekuivalent me komitetet e përhershme, përndryshe e rekomandojmë dhe presim ekzistencën e një rregulloreje të tillë në mënyrë që të pasurohet edhe më shumë, të jetë e rregulluar dhe më e pranishme jeta kulturore në Komunën e Podujevës.

z.Florent Hasani, theksoi, Grupi i këshilltarëve nga radhët e LVV-së e rekomandojmë për seancën e radhës së Kuvendit këtë pikë të rendit të ditës.

z.Rafet Llapashtica, theksoi, edhe ne Grupi i këshilltarëve nga radhët e LDK-së i rekomandojmë Kuvendit si pikë të rendit të ditës për seancën e radhës.

znj.Elhame Kutllovci, drejtoreshë e DKRS-së, theksoi, realisht në nenin 2 të propozim Rregullores nuk përcaktohet që anëtari në fjalë të jetë nga radhët e DKRS-së apo i ndonjë Drejtorie tjetër, prandaj duhet të jetë i hapur, por në këtë rast Këshilli Drejtues i Teatrit të Qytetit "Avdush Hasani" është duke funksionuar dhe ne kemi caktuar një zyrtar nga DKRS, arsyeja pse është pikërisht nga kjo Drejtori se ndoshta është më shumë në rrjedha të aktiviteteve të Drejtorisë dhe mund ta jap kontributin e tij, pra nuk përcaktohet dhe mund të jetë dikush edhe prej Drejtorive tjera.

z.Fatmir Gashi, Kryesues i Komitetit, theksoi, faleminderit parafolësve dhe drejtoreshës së DKRS-së, me rëndësi është që të përfillen rregullat dhe aktet normative ligjore në mënyrë që të mos na kthehen vendimet prapa. Nëse nuk ka dikush çfarë të shtoj e hedh në votim.

Njëzëri i rekomandohet Kuvendit si pikë e rendit të ditës për seancën e radhës.

4. Propozim vendimi për ngritjen e komisionit përzgjedhës - për zhvillimin e procedurave për përzgjedhjen e drejtorëve dhe zëvendësdrejtorëve në institucionet publike edukativo arsimore në Komunën e Podujevës

z.Avni Fetahu, drejtor i Drejtorisë së Arsimit-DKA, theksoi, siç jeni në dijeni prej datës 01 qershor 2021 është në njoftim publik konkursi për 33 pozita drejtor dhe zëvendës drejtor të institucioneve arsimore në Komunën e Podujevës. Me Udhëzimin Administrativ – MASH të datës 24 dhjetor 2020 është paraparë që komisioni të formohet për një konkurs të caktuar me mundësi deri në 1 vit, andaj e kemi propozuar komisionin me përbërjen e njëjtë siç ka qenë ai paraprak sa i përket nivelit komunal, ndërsa sa i përket anëtarëve që parashihet t'i dërgoj Ministria e Arsimit ata i delegojnë vetë anëtarët. Kështu që ky është një propozim vendim dhe kërkoj nga ju që ta përkrahni në mënyrë që pastaj të mundësohet zhvillimi i procedurave tjera.

Njëzëri i rekomandohet Kuvendit si pikë e rendit të ditës për shqyrtim në seancën e radhës.

5. Informatë e Drejtorisë së Planifikimit Urban dhe Mbrojtjes së Mjedisit, rreth procesit të Hartës Zonale të Komunës

z.Bujar Hasani, drejtor i Drejtorisë së Planifikimit Urban dhe Mbrojtjes së Mjedisit-DPUMM, theksoi, e kemi parë të arsyeshme t'ju informojmë rreth gjendjes deri ku ka arritur draft Harta Zonale dhe përse nuk është sjellë për miratim apo diskutim. Me marrjen e detyrës drejtor i DPUMM në mes të muajit dhjetor e kemi gjetur një draft Hartë Zonale e cila e ka pasur një pëlqim prej Ministrisë së Ambientit por pas analizimit të saj kemi ardhur në përfundim që ka pasur lëshime të shumta thuajse në shumë pika dhe në shumë fusha që për mendimin tonë dhe në analizën që e kemi bërë e cenon funksionimin e drejtë të saj dhe funksionim të rregull brenda në qytet. Diskutimi këtu ka të bëjë më shumë rreth pikave që kemi vendosur për t'i ndryshuar, dhe po ashtu me GIZ-in Gjerman problemet që i kemi hasur janë në blloqet brenda përbrenda zonës urbane, kemi pasur probleme edhe tek zona ekonomike për lejimin e saj që e kemi propozuar, kemi hasur probleme edhe tek objektet bujqësore që nuk janë trajtuar fare, ndërsa me Hartën Zonale të Kosovës janë trajtuar si pikë e veçantë që çdo objekt që është në shfrytëzim të bujqësisë kemi të drejtë për trajtim dhe për t'i lëshuar kushtet ndërtimore. Pastaj kemi edhe brezin rrugor Podujevë-Prishtinë që kemi kërkuar për ta ndryshuar këtë dispozitë në mënyrë që të kemi mundësi t'i trajtojmë dhe të lëshojmë leje ndërtimore. Pra kjo është e gjitha rreth kësaj pike.

z.Mehmet Gashi, thekoi, unë në këtë lami nuk jam profesionistë dhe nuk mund të flas shumë, mirëpo ju e dini që ka qenë ky propozim për tu miratuar në Kuvend në muajin tetor 2020 nëse nuk gaboj, dhe shkak që nuk është miratuar ka qenë se unë në emër të Grupit të këshilltarëve të LDK-së kam propozuar të shtyhet kjo pikë për shkak se para anëtarëve të Kuvendit dhe Ekzekutivit asnjëherë nuk kanë dal për të na informuar dhe njoftuar më shumë në pika të shkurtra qoftë edhe përmes projektorit në mënyrë që t'i shohim edhe në çështjet kryesore që trajtohen me këtë dokument, dhe kemi shkuar në Kuvend pa e ditur se çka po shqyrtojmë dhe miratojmë.

Gjithashtu pastaj edhe Grupet tjera të subjekteve politike përfshirë edhe Grupin e LVV-së e kanë përkrahur shtyrjen e pikës në fjalë mirëpo kjo çështje është shtyrë paksa shumë. Unë mendoj që sa më shpejt që të miratohet Harta Zonale është në interes të qytetarëve për t'iu mundësuar marrjen e lejeve ndërtimore dhe lejeve tjera urbanistike. Pra të gjenden mundësitë për rregullimin e çështjeve për të cilat ka vërejtje aty ku mendoni se duhet rregulluar. Në emër të Grupit të këshilltarëve të LDK-së po them që nëse ne si anëtarë të Kuvendit nuk ftohemi në një debat për të na informuar në detaje qoftë edhe përmes projektorit, ne nuk do ta përkrahim dokumentin që pritet të sjellët në Kuvend për shqyrtim dhe miratim, andaj këtë duhet ta dini sepse shumica nuk e përkrahim, mirëpo eksperti përkatës na njofton me ndryshimet e bëra, për zonat përkatëse se për çfarë veprimtarie janë paraparë dhe çështje tjera, kështu që ju lus që sa më shpejt që është e mundur së bashku edhe me ndihmën e GIZ-it Gjerman të zhvillonin debate me qytetarë të atyre zonave ku mund të ketë pakënaqësi, të sjellët në Kuvend për miratim sepse pa Hartë Zonale, drejtori i DPUMM sigurisht se është në dijeni se ka pengesa për dhënien e lejeve të ndërtimit, kështu që është bërë gati 7-8 muaj dhe nuk ka lëvizë asgjë, prandaj e përsërisë se është mirë që sa më shpejt t'i bëni ndryshim-plotësimet e nevojshme dhe dokumenti të sjellët në Kuvend për shqyrtim.

z.Fatmir Gashi, Kryesues i Komitetit, theksoi, mendoj që sa i përket informimit për këtë dokument mjaft të rëndësishëm është edhe obligim ligjor që Ekzekutivi i Komunës, përkatësisht sektorët përkatës, gjithsesi edhe asamblistët të jenë mirë informuar dhe me detaje se çfarë propozohet për votim.

z.Florent Hasani, theksoi, ne Grupi i LVV-së e dimë rëndësinë e Hartës Zonale të Komunës e cila pas aprovimit të saj do të hapte perspektiva të reja si për Komunën e Podujevës ashtu edhe për qytetarët, andaj themi se duhet të shtyhet përpara kjo çështje dh sa më shpejtë të përfundohet dokumenti në fjalë, andaj këtë pikë të rendit të ditës e mbështesim që të rekomandohet për seancën e radhës së Kuvendit.

z.Rafet Llapashtica, theksoi, edhe ne Grupi i këshilltarëve nga radhët e PDK-së e rekomandojmë këtë pikë të rendit të ditës për seancën e radhës së Kuvendit.

z.Bujar Hasani, drejtor i DPUMM-së, theksoi, e gjithë kjo iniciativë për ndryshimin e pikave ka ardhur bashkërisht me GIZ-in Gjerman duke bërë vlerësimin e dokumenteve të mëhershme pasi kemi analizuar draftin e Hartës Zonale dhe kemi ardhur në përfundim që t'i bëjmë këto ndryshime, pra kemi analizuar gjitha dokumentet që prej Planit Zhvillimor Komunal që është hartuar në vitin 2009 dhe është miratuar në vitin 2016. Pra në materialin që ju është përcjellë unë e kam sqaruar se si ka rrjedh deri tek këto ndryshime që kanë ndodhur. Tani ne kemi shumë telashe edhe në trajtimin brenda – përbrenda zonave urbane, konkretisht tokave ndërtimore që i kanë lejuar dhe nuk kanë jap mundësi për zgjerim edhe të familjeve tjera dhe për këtë shkak unë kam insistuar që dokumenti në fjalë të kthehet prapa dhe të bëhen ndryshime plotësime para sjelljes në Kuvend për shqyrtim dhe miratim. Diçka tjetër nuk kam por shpresoj që do ta mbajmë një prezantim sa më të mirë të mundshëm qoftë edhe me projektor pse jo, përveç kësaj secili nga Ju derën e zyrës ku unë punoj e keni të hapur për t'ju jap informata për çdo detaj, ndërsa çështjet tjera sigurisht se do të ngritën edhe në mbledhjen e Kuvendit ku edhe besoj se do të japim përgjigje dhe sqarimet e nevojshme rreth dokumentit / draftit të Hartës Zonale të Komunës.

Njëzëri i rekomandohet Kuvendit si pikë e rendit të ditës për diskutim/informim në mbledhjen e radhës.

6. Rishqyrtimi i Vendimit nr.prot.01-020/04-0035824/21 i datës 29 prill 2021, i ndërlidhur me Vendimin nr.prot.01-020/04-0026812/18 të datës 28 mars 2018 për ngritjen e Komisionit për ndarjen e shtëpive në pronësi të Komunës në “Lagjen e Dëshmorëve” në fshatin Balloc

- Shkresa e Ministrisë së Mjedisit, Planifikimit Hapësinorë dhe Infrastrukturës nr.02-1804-2/21 e datës 08.06.2021, e përcjellë përmes Ministrisë së Pushteti Lokal - Shkresa nr.020-396/10 të datës 10.06.2021

z.Fatmir Gashi, Kryesues i Komitetit, theksoi, siç e keni materialin para vetës Ministria e Pushtetit Lokal e ka kthyer në rishqyrtim këtë vendim dhe arsyet janë të treguara edhe në materialin që e keni para vetës, do të thotë sipas tyre është çështje ekskluzive e Kryetarit të Komunës formimi i komisionit për ndarjen e shtëpive, jo çështje e Kuvendit, kështu që ne e kemi afatin 30 ditë për rishqyrtim dhe këtë vendim e kemi para vetës, urdhëroni nëse dikush ka diçka për të shtuar, materialet ua kemi përcjell të gjithëve për informatë nëse dëshiron ta marr dikush fjalën urdhëroni.

z.Rafet Llapashtica, theksoi, tani ose duhet ta shfuqizojmë vendimin në fjalë ose ta rishqyrtojmë sepse është i pa ligjshëm. Vendimi në fjalë është miratuar më 28 maj 2018, një komision ka qenë ligjërisht në fuqi dhe është dashur ta plotësojmë me një anëtarë të LVV-së për shkak të ndryshimeve politike, përkatësisht me shkuarjen e z.Vendenis Lahu Deputet në Kuvendin e Republikës së Kosovës dhe e kemi bërë plotësimin e tij, proceduralisht duhet bazuar në një arsyeshmëri prej Ministrisë përkatëse vendimi i plotfuqishëm, sepse bëhet fjalë për plotësim-ndryshim sepse ne keni bërë vetëm plotësimin e përbërjes së komisionit përkatës, nuk kemi bërë ndryshim të vendimit, të paktën kjo duhet shikuar edhe në procesverbalin e mbledhjes përkatëse sepse pa keqkuptime por nganjëherë në të gjitha institucionet ka zyrtar që kanë hyrë aty por që lidhje me administratë nuk kanë. E them këtë për arsye që nëse e ka kthyer vendimin që ky plotësim ndryshim është kompetencë e Kryetarit të Komunës, rastin në fjalë që e kemi plotësuar me z.Ragip Fetahun ata gjithë vendimin / komisionin e kanë bërë të kundërligjshëm dhe për këtë arsye është dashur Zyra ligjore e Kuvendit dhe këshilltari ligjor i Kryetarit të konsultohet përmes e-mailit me zyrtar të Ministrisë përkatëse dhe t'iu thuhet që ne tani jemi të detyruar të kthehemi në pikën zero, ta

shfuqizojmë vendimin që ka qenë në fuqi edhe me protokoll, është në arkivin e Ministrisë dhe në arkivin e Komunës si vendim i ligjshëm ngase ka pasë përgjigje për të.

Pastaj anëtarët e Kuvendit nuk cakton Kryetari i Komunës për komisione sepse decidivisht thuhet që duhet të caktohet komisioni prej 3 anëtarëve, 2 ose 3 prej Kuvendit dhe 1 prej Ekzekutivit i cili është në kompetencë të Kryetarit të caktohet, pra ne nuk kemi bërë ndërhyrje në anëtarin e Ekzekutivit por në atë të Kuvendit dhe në mënyrë unanime është mbështetur propozimi i LVV-së, kështu që ata (Ministria) e kanë kthyer por mendoj që duhet të sqarohet kjo çështje, në të kundërtën i bie që duhet ta shfuqizojmë edhe vendimin bazë të themelimit të Komisionit në fjalë, dhe të veprohet sipas Ligjit ashtu siç kërkohet nga Ministria, mirëpo Ligji është ai që ka qenë dhe nuk ka pësuar plotësim ndryshime ose amendamentim që do ta hiqte prej funksioni ligjin paraprak, madje sipas procedurave edhe nëse ky komision është ngritur sa ka qenë në fuqi ai ligj i njëjti duhet të vazhdon deri në përfundim sepse është ngritur për një periudhë kohore deri sa të shpërndahen gjitha shtëpitë në “Lagjen e Dëshmorëve”, po flas në aspektin juridik kështu që ne tani si Kuvend nuk e dimë se si ta rregullojmë këtë çështje, është dashur menjëherë kur është kthyer përgjigja të trajtohet kjo edhe nga zyra ligjore e Kuvendit dhe të njoftohet Kryetari, ngase edhe me heq prej funksioni atë komision duhet të merret vendim dhe të referohemi në dispozitë ligjore.

Ministria nuk mund ta bëjë atë sepse nuk ka dispozitë se ku të referohet, sepse Ministria është thirrur në një vendim që domethënë nuk është vetëm vendim por edhe veprim politik, kështu që ne si Kuvend nuk kemi çfarë të bëjmë sepse bllokohet puna në atë Lagje pastaj ngase tani as shpërndarja e shtëpive nuk mund të bëhet pa pasur komision të ngritur, këtu është problemi tani dhe sqaroheni si institucion i Komunës këtë çështje, përndryshe në seancën e Kuvendit nuk ka çfarë thotë askush asgjë sepse ne nuk jemi kundër edhe i gjithë Ekzekutivi me qenë anëtarë në atë komision, por nuk e ka rregulluar vendimi i kaluar ashtu domethënë. Sipas ligjeve në fuqi, të gjitha komisionet që janë të përbashkëta Kuvend Ekzekutiv, formohen me propozime të Ekzekutivit për anëtarët e vet dhe propozimet e Kuvendit për anëtarët e vet, tani në seancën e Kuvendit që do të mbahet të hënën ne vetëm mund të bisedojmë kështu sikurse sot por jo të marrim ndonjë vendim.

Unë nuk po e kuptoj si e ka jap arsyeshmërin Ministria duke thënë se është ndërhyrë në kompetenca të Ekzekutivit, sikur të më thonë mua tani si këshilltar i Kuvendit ke ndërhyrë në punën e Kryesuesit kur të marrim një vendim, e që për një gjë të tillë duhet të specifikohet me dispozitë konkrete të ligjit apo aktit nënligjor përkatës që e rregullon këtë çështje e jo vetëm të thuhet keni ndërhyrë në punët e Kryetarit, nuk është përgjigje ajo sepse është dashur vetëm përmes një e-maili t’iu kërkohet dispozita se ku kemi ndërhyrë ne si Kuvend në detyrën e Kryetarit të Komunës dhe ishte sqaruar kjo çështje. Unë jam shumë i sigurt që nuk mund të jap përgjigje askush nga Ministria mirëpo ai zyrtar ndoshta ka qëlluar aty në zyrë dhe e ka kthyer përgjigjen duke i thënë ndokush që është punë e Kryetarit, e ashtu nuk punohet në institucion dhe ai zyrtar kushdo qoftë e ka gabim total, madje madje konsideroj se kjo nuk është detyrë e Kryetarit fare. Unë edhe tek rregullorja e DKRS-së nëse propozimin e sjell Drejtoria në këtë rast ta zëmë për Këshillin Drejtues të Teatrit dhe gjithë rregulloren e sjellë vetë ajo Drejtori pastaj është kompetencë ekskluzive edhe të shikoj se çfarë bëhet me atë, pra është çështje e drejtorit përkatës të Kryetarit që e kishte emëruar në atë Drejtori sepse Kryetari i emëron dhe shkarkon drejtorët siç është rasti i DKRS-së e cila madje e ka anëtarin e vet në përbërjen e Këshillit të cekur i cili e informon direkt drejtoreshën e DKRS-së për çështjet që lidhen me Teatrin dhe punën e Këshillit.

Unë po i bëjë disa kritika e që nganjëherë ndoshta po i bie sikur po debatohet diçka vetëm pse nuk jemi në pushtet por ne jemi për ta mbështetur çdo hap para sipas kornizës ligjore, unë po flas individualisht jo në emër të PDK-së por si Rafet. Pra nuk mund të kthehet përgjigje konkrete nga zyrtari i Ministrisë për arsye se unë dua që kur të kthehet përgjigja të më sjellët edhe dispozita ligjore se ku është referuar sepse pushteti lokal rregullohet me ligjet që janë në funksion. Madje është dashur t’i bëjmë pyetje Ministrisë që të rishikoj komisionet e ngritura nga Kuvendi për çështjen në fjalë si janë të rregulluara, e që unë po ju

them se në Kosovë nuk ka të rregulluar askund komisione ashtu siç e ka kthyer përgjigjen zyrtari i Ministrisë përkatëse dhe për këtë mund të komunikohet edhe me komuna tjera sepse shtëpi të tilla kanë ndarë edhe Komuna e Drenasit nëse nuk gabo, pastaj edhe ajo e Skenderajt dhe shumë komuna tjera ngase po thuajse të gjitha komunat kanë raste të ndarjes së shtëpive ashtu siç i kemi ne.

Dua të them që edhe po të shtyhet kjo çështje për 1 javë deri sa të sqarohet në detaje kjo çështje nuk paraqet problem, por nuk e mbështes që ne tani blanko të japim votën dhe ta shfuqizojmë një vendim sipas të cilit është bërë plotësimi i një anëtari në një komision të Kuvendit, mund ta ndryshojmë atë përbërje dhe lirshëm mund ta vëni në votim ne si PDK e mbështet cilindo propozim që subjekti në fjalë dëshiron të bëjë ndryshimin sepse i takon asaj partie dhe e japim votën, por ka për të imponuar në shpërndarjen e shtëpive atje në “Lagjen e Dëshmorëve” për t’i ndërtuar sepse duhet të reflektoi sepse tani detyrohet të reflektoi, jo për hir që duhet t’i kaloj Kryetarit kjo çështje, por për shkak të një “budallallëku” të një njeriu (fjalën e ka për zyrtarin/en e Ministrisë që ka bërë vlerësimin e ligjshmërisë së vendimit në fjalë) i cili mundohet me u shit më i mençur edhe se Kryetari i Komunës edhe se Kryesuesi i Kuvendit dhe i gjithë Kuvendi dhe i mençur se drejtorët e Drejtorive, ndërsa në realitet nuk dinë asgjë, këtu është problemi sepse pastaj duhet t’i shkojmë deri në fund kësaj çështje duke mos përjashtuar as edhe ndonjë kallzim atij zyrtari dhe të merremi konkretisht me atë.

Unë jam që dy mandate dhe edhe në të kallurën kemi pas vendime të cilat janë kthyer për rishqyrtim, por në shkresat përkatëse të Ministrive në mënyrë specifike është dërguar orientimin se si rregullohet çështja përkatëse duke cituar nenet e ligjeve, udhëzimeve administrative dhe akteve tjera që rregullojnë atë fushë, kurse tani nuk kemi asnjë dispozitë konkrete për këtë që po diskutojmë dhe nuk kemi çka diskutojmë madje por vetëm duhet me marr edhe një vendim për shfuqizim të Komisionit, duhet me i largu të gjithë anëtarët e komisionit që janë përfaqësues të partive politike në atë komision sepse nuk është problemi vetëm i anëtarit të LVV-së, por duhet të tërhiqen të gjithë, prandaj konsideroj se nuk është ashtu fare siç ka thënë Ministria apo zyrtari përkatës i saj. Sido që të jetë sqaroheni deri të hënën në mbledhje të Kuvendit dhe kërkon përgjigje konkrete edhe nga zyra ligjore e Kuvendit dhe nga këshilltari ligjor i Kryetarit ose nga Kryetari vet. Unë nuk jam kundër që Kryetari të caktoj anëtarët e komisionit në fjalë sepse ato punë janë kryer dhe janë ndarë ato shtëpi të cilat i’u takojnë atyre familjeve që i kanë vendimet dhe ato nuk mund të tjetërsohen përveç nëse ndonjëri prej tyre mund të thotë se nuk dëshiron shtëpi në atë lagje dhe mund ta gjeni një familje tjetër ngase standardi i jetesës dhe banimit është rregulluar dhe kaq, mirëpo sa i përket përgjigjes së Ministrisë, ne si Kuvend jemi në një pozitë jo të mirë, madje unë jam hutuar edhe kur ka ardhur materiali për këtë çështje.

Si do që të jetë sjellni propozimin të hënën në mbledhjen e Kuvendit, i tërheqim anëtarët e komisionit nga radhët e Kuvendit dhe ta emëron Kryetari i Komunës një komision, mirëpo kur të emëron Kryetari një komision për çështjen në fjalë atëherë unë si Rafet, jo si PDK, do të marr hapa konkret ta shkojmë se si mundet tani Kryetari ta emëroj një komision të tillë, kjo sepse nuk ka dispozita konkrete që e rregullojnë këtë, madje po që se edhe Kryetari i PDK-së po të ishte nuk do ta lejoja të shkojë në këtë formë ashtu siç ka thënë zyrtari i Ministrisë lidhur me këtë vendim, sepse nuk bëhet puna ashtu, jo që më pengon mua apo ndonjërin prej anëtarëve ngase kam besim sepse nuk ka çfarë të bëjë aty në atë Lagje.

Po ashtu, të vendoset ky institucion i Komunës së Podujevës, prej Zyrës së Kryetarit të Komunës e deri tek sporteli, nga një zyrtar “analfabet” atje i Ministrisë i cili me një përgjigje në letër nuk mund ta pranoj, jo që jam kundër për ta ndryshuar komisionin. Unë jam shumë i sigurt që me këtë çështje nuk është marr askush nga Komuna e Podujevës që t’i reagohet Ministrisë dhe t’i shtrohet pyetje përse vendimi është i jashtëligjshëm, përse shembull nuk ishte i jashtëligjshëm z.Vendenis Lahu kurse tani z.Ragip Fetahu po edhe nëse ka qenë i jashtëligjshëm, përse është punuar jashtëligjshëm që 2 vite, tani ne jemi përfaqësues në njëfarë forme deri në shtator-tetor kur të mbahen zgjedhjet e që nuk dihet a do të jemi kandidat për asamble komunale ose diku tjetër apo se si të vije puna, por sido që të jetë sa të jemi ulur këtu si anëtarë të

Kuvendit të paktën ai zyrtar që jemi duhet ta dijë secili që shaka nuk mund të bëjë as me drejtor të Drejtorive as me askënd tjetër sepse nuk është çështje partiake këtu por është punë, vend dhe institucion.

z.Mehmet Gashi, theksoi, nuk kam çfarë të shtoj asaj që e ceku z.Rafet Llapashtica sepse nuk jam jurist por nga përvoja e dimë se si funksionon kjo çështje. Vërtetë është paksa nënçmuese kur një zyrtar i Ministrisë vendos Kuvendin e Komunës në këtë pozitë çfarë edhe është, madje jeni në dijeni se kjo çështje pastaj evidentohet edhe në performancën e Komunës si dobësi nëse ne ua miratojmë kështu pa asnjë telashe kinse kemi gabuar në marrjen e vendimit në fjalë. Këtë çështje më së miri e din zyra ligjore dhe është mirë të angazhohet sepse është goxha problem që vendimet e Ministrive t'i sistemoj.

Nëse vendimi në fjalë bazë kur është marrë në vitin 2018 ka qenë i ligjshëm dhe Ministria e ka lejuar si të ligjshëm, ligjet më nuk kanë ndryshuar, ai ligj që ka qenë në fuqi atëherë është edhe tani, por tani të shpallet i pa ligjshëm vendimi nuk më duket e arsyeshme, madje po t'më pyetni mua do të sugjeroja ta merrni vendimin bazë të vitit 2018 dhe konfirmimin e tij nëse ka dhe zyra ligjore së bashku me Kryesuesin e Kuvendit të shkojnë dhe të takohen me zyrtarët përkatës të Ministrisë përkatëse dhe të sqarohet në detaje sepse në qoftë një zyrtar i asaj Ministrie në vitin 2018 njëherë ka thënë se vendimi në fjalë është i ligjshëm kurse tani zyrtari tjetër ka menduar se nuk është i ligjshëm atëherë faji është i tyre, mirëpo ashtu siç e tha z.Rafet Llapashtica, të merret vendimi bazë i vitit 2018 së bashku me vlerësimin e ligjshmërisë së tij, të sqarohet dhe nëse është ashtu siç kanë thënë Ministria të themi se kemi gabuar dhe kërkojmë falje por të njëjtën ta bëjnë edhe zyrtarët e Ministrisë nëse është e kundërta sepse nuk është që dëshiron askush që me çdo kusht të jetë pjesë e atij komisioni ngase vetëm telashe ka ky komision, ndërsa vendimin është shumë lehtë ta marrim, vetëm i ngritim duart.

z.Rafet Llapashtica, theksoi, nuk ka ligj që është në funksion që mund ta specifikoj konkretisht dhe as të mendohet asnjëherë që Kuvendi i Komunës nëse dëshiron të rregulloj një çështje siç është ngritja e komisionit në fjalë për ndarjen e shtëpive. Komisioni i cekur ka qenë i rregulluar dhe ngritur në përbërje prej anëtarëve të Kuvendit, Ekzekutivit dhe 1 anëtar nga Shoqatat e dala nga lufta, kështu ka qenë nëse nuk gabojë dhe janë ndarë shtëpitë në "Lagjen e Dëshmorëve" po nga ai komision, mirëpo këtu problemi është që po kontestohet personi e jo përbërja e komisionit dhe aq më tepër që është nga radhët e partisë që është në udhëheqje sepse po të ishte nga radhët e opozitës, ndërsa z.Vendenis Lahu është zëvendësuar nga z.Ragip Fetahu dhe tani është kontestuar, prandaj çfarë zyrtari është ai zyrtar i Ministrisë, kjo i bie një farë këmbëngulje e që nuk do ta lejoja këtë, madje është mirë që ne si Kuvend ta rikthejmë atë vlerësim të ligjshmërisë me kërkesë që ta rishikoj bazën ligjore edhe njëherë Ministria përkatëse sepse komisioni në fjalë i ka shpërndarë mbi 30 shtëpi në "Lagjen e Dëshmorëve", dhe nëse i ka shpërndarë jashtëligjshëm me punën e tyre, tani duhet t'i kthejmë, të shkojmë t'ua marrim çelësat atyre familjeve e të cilat e kanë vendimin për një gjë të tillë, prandaj unë nuk po e kontestoj këtë, por po e kontestoj punën e një zyrtari të Ministrisë i cili në këtë rast po del që ka "karrige më të madhe" se Kryetari i Komunës edhe se ju Kryesues i Kuvendit dhe se gjithë drejtorët e Drejtorive, zyrtar i cili shkruan një letër ose e-mail sikur t'ia dërgon një bujku, madje një bujku të pashkolluar të viteve 70-ta, veç pse ai mendon ashtu, dhe mendon se askush nuk lexon asgjë në këtë aspekt sikurse që është vetë ai i cili është ulur si "dordolec" në atë zyre.

Në këtë çështje mendoj se nuk ka nevojë Komuna e Podujevës të merr performancë, madje as ne si opozitë nuk po themi se vendimi i Kuvendit ka qenë i jashtëligjshëm dh ka performancë të jashtëligjshme sepse për mendimin tim nuk kemi marrë asnjë vendim të jashtëligjshëm qoftë ne si Kuvend qoftë Kryetari i Komunës sa i përket çështjes në fjalë, ne jemi këtu për të dëgjuar dhe dërguar proceset përpara, dhe këtë po e them sepse vlerësimi është dhënë jashtëligjshëm dhe unë ju garantoj nëse ndokush fol këtu në emër të Kryetarit dhe kërkon të rregullohet komisioni në fjalë, nuk do të ketë përgjigje sepse nuk dinë askush ngase nuk guxon ta shkel ligjin, qoftë edhe zyrtari i Ministrisë.

Kështu që për seancën e Kuvendit do të rekomandoja të hiqet kjo pikë nga rendi i ditës, dhe që Kryetari i Komunës ta marr përsipër edhe njëherë shqyrtimin e kësaj çështjeje sepse ndryshe është tani të merret

Kryetari i Komunës me këtë çështje n'raport me Ministrinë përkatëse ndryshe ne si anëtar të Kuvendit, përndryshe le ta propozon Kryetari i Komunës një komision dhe ne ua miratojmë, por nuk bëhet ashtu siç ka thënë Ministria përmes vlerësimit për vendimin në fjalë.

z.Fatmir Gashi, Kryesues i Komitetit, theksoi, ju sqaroj se sipas raportit të vlerësimit të vendimit në fjalë që e ka dërguar Ministria përkatëse, ne jemi të obliguar ta paraqesim para Kuvendit për rishqyrtim të vendimit, në këtë rast duhet ta rekomandojmë për shqyrtim në seancën e radhës së Kuvendit, pra me rëndësi është të dihet ligjshmëria dhe vendimi të jetë më i duhuri për qytetarët.

z.Florent Hasani, theksoi, ne Grupi i këshilltarëve nga radhët e LVV-së mendojmë që patjetër zyra ligjore duhet të merret me tematikat e çështjes së kësaj pike, përndryshe është e arsyeshme t'i rekomandohet Kuvendit për shqyrtim më të gjerë në seancën e radhës dhe të merret vendimi i duhur në mënyrë që të ecim tutje.

z.Fatmir Gashi, Kryesues i Komitetit, theksoi, nëse ndokush dëshiron fjalën, urdhëroni, nëse jo atëherë e hedh në votim për t'i rekomanduar Kuvendit për shqyrtim të kësaj pike në seancën e radhës.

Njëzëri i rekomandohet Kuvendit si pikë e rendit të ditës për shqyrtim në seancën e radhës.

Kryesuesi i Komitetit e konstatoj të përfunduar këtë mbledhje.

Mbledhja përfundoi në orën 11:00

Procesverbalin e mbajti

Enis Sheholli

Nr.01-060/04-0050936/21

Podujevë,

25 qershor 2021

Kryesuesi i Komitetit

Fatmir Gashi